

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 311, datë 30.11.2022, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s” nr. 161, datë 17.6.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instaluar 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 22.12.2022, bëhet korrigjimi i pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, si më poshtë vijon:

1. Pika 2 e vendimit nr. 311/2022 ndryshon dhe bëhet:

2. *Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja dëjani e vendimit:*

a) vërtetimet e gjykatës për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

b) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;

c) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.